



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 88-të, të mbajtur më 16.06.2023, morri vendimin vijues:

### VENDIM

Denoncimi me numër 12-9268/1 të datës 14.11.2022 me pretendime për pakënaqësi nga veprimi sipas çështjeve gjyqësore pran -----HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent në këtë temë, sepse veprimet e raportuara nuk janë në juridiksionin e KSHPK-së, dhe në rastin në fjalë bëhet fjalë për shkelje të së drejtës individuale kërkuesit për të cilin është në proces procedura pranë një autoriteti tjetër kompetent gjyqësor.

Lënda me numër 12-9268/1 të datës 14.11.2022r të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së- brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

### Arsyetim

Një parashtrues i njohur, më 14.11.2022, ka dorëzuar denoncim të regjistruar me numër 12-9268/1 të datës 14.11.2022, pas së cilës është formuar lënda me pretendime për pakënaqësi me trajtimin e lëndëve gjyqësore në ----- . Në rastin konkret bëhet fjalë për një çështje juridike në të cilën paditëse është parashtruesi i kërkesës, në të cilën ----- i datës 14.06.2021 ka qenë i plotfuqishëm dhe për të cilin pas një kërkesë për rishikim për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës civile dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, është ngritur rasti me ----- dhe në momentin e paraqitjes së kërkesës në KSHPK, çështja ligjore në fjalë ishte në fazën e vendimmarrjes para Gjykatës Supreme të RMV-së.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, KSHPK-ja konstaton se në rastin në fjalë veprimet e raportuara nuk janë në juridiksionin e KSHPK-së dhe bëhet fjalë për shkelje të një të drejte individuale të kërkuesit për të cilën është në proces një procedurë pranë një organi tjetër gjyqësor kompetent. KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim kompetent dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: J.C.

Miratoi: Mr. SH.S, anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
Nënkryetar,  
Katica Nikolovska**

